



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
PRISHTINË
FAKULTETI JURIDIK**

**E DREJTA FAMILJARE DHE
TRASHËGIMORE**

**PLANPROGRAMI MËSIMOR
(SYLLABUS)**

PRISHTINË, 2019

PLANPROGRAMI MËSIMOR (SYLLABUS)

LËNDA E DREJTA FAMILJARE DHE TRASHËGIMORE

BARTËS I LËNDËS - LIGJËRUES:

Prof. Ass. Dr. Bedri BAHTIRI, bedri.bahtiri@uni-pr.edu

VITI I DYTË, SEMESTRI VEROR - VITI AKADEMIK 2018/19

I. PËRSHKRIMI I LËNDËS:

Lënda E Drejta Familjare, përfshinë tërësinë e studimeve që i referohen marrëdhënieve familjare dhe martesore si dhe marrëdhënieve që lindin nga to. Kjo disiplinë shkencore merret me studimin e dispozitave ligjore pozitive me të cilat rregullohen marrëdhëniet familjare, marrëdhëniet martesore, marrëdhëniet në bashkësinë jashtëmartesore, marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve, si dhe format e mbrojtës së veçantë të fëmijëve pa kujdesin prindëror siç janë: adoptimi, kujdestaria dhe vendosja e fëmijëve në familjen tjetër.

Institucionet juridike që janë objekti i studimit në të drejtën familjare, do të trajtohen duke u bazuar në të drejtën pozitive në Kosovë si dhe në të drejtën familjare krahasuese me sistemin Kontinental dhe Common Law.

E drejta familjare është pjesë e sistemit juridik e gjithashtu është disipline e veçantë shkencore.

1. E drejta familjare si pjesë e sistemit juridik, përfshinë tërësinë e dispozitave ligjore me të cilat rregullohen marrëdhëniet familjare siç janë: familja, fejesa, martesa, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimi, kujdestaria, mbrojtja e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës përkitazi me kontestet lidhur me marrëdhëniet familjare. E drejta familjare si pjesë e sistemit juridik me anë të normave juridike pozitive i rregullon marrëdhëniet familjare, prandaj është degë pozitive e së drejtës.

2) E drejta familjare si disiplinë shkencore, nënkupton tërësinë e studimeve mbi marrëdhëniet familjare dhe martesore si dhe marrëdhëniet tjera që lindin nga to. Këto studime i referohen studimit të normave juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet familjare dhe martesore duke sqaruar kuptimin e tyre (*de lege lata*). Përveç shpjegimit të kuptimit të normave juridike kjo disiplinë shkencore i komenton normat juridike, i shpjegon paqartësitë juridike dhe fenomenet shoqërore të karakterit juridiko-familjar, jep kritika dhe sugjerime për rregullimin më të mirë të marrëdhënieve familjare në të ardhmen (*de lege ferenda*). Mund të themi se e drejta familjare si disiplinë shkencore e krijon teorinë e së drejtës e cila përfshinë tërësinë e mendimeve teorike mbi marrëdhëniet familjare.

E drejta familjare, për objekt studimi ka marrëdhëniet familjare jo vetëm ato personale por edhe ato pasurore. Në kuadër të marrëdhënieve personale familjare studiohen të drejtat dhe detyrat personale të subjekteve në secilin raport familjar (të drejtat dhe detyrat e bashkëshortëve, të drejtat dhe detyrat e prindërve dhe fëmijëve, të drejtat dhe detyrat e adoptuesit dhe të adoptuarit, të kujdestarit dhe të kujdesuri etj) . Ndërsa në kuadër të marrëdhënieve pasurore, studiohen të drejtat dhe detyrat pasurore të subjekteve në raportet familjare (pasuria e përbashkët e bashkëshortëve, detyrimi i ushqimit për bashkëshortin e pasiguar, detyrimin e ushqimit në mes të personave në gjini, kujdesi dhe mbajta e fëmijëve etj).

E drejta familjare, përveç studimit të normave materiale i studion edhe normat procedurale, me të cilat rregullohen procedurat e veçanta për krijimin, ndryshimin, dhe shuarjen e marrëdhënieve juridike-familjare si, p.sh procedua e lidhjes së martesës, procedurat e zgjidhjes së martesës, procedurat e themelimit të adoptimit etj.

Lënda E Drejta Trashëgimore, përfshinë tërësinë e studimeve që i referohen marrëdhënieve që lindin në rastet e trashëgimit, përkatësisht në rastet e vdekjes së trashëgimlënësit dhe realizimi i trashëgimit nga trashëgimtarët. Ndryshe kjo lëndë e drejta trashëgimore i rregullon marrëdhëniet e subjekteve në rastet e vdekjes, marrëdhëniet *mortis causa*.

Kjo disiplinë shkencore merret me studimin e dispozitave ligjore me të cilat rregullohen marrëdhëniet që lindin në rastin e vdekjes së ndonjë personi, përcaktimin e pasurisë trashëgimore, subjektet e trashëgimit, rendet ligjore të trashëgimit, trashëgiminë e domosdoshme, përjashtimet nga trashëgimi, testamentin dhe llojet e testamentit, pavlefshmëritë e testamentit si dhe procedurat lidhur me hapjen, ndarjen dhe realizimin e trashëgimit në përgjithësi.

E drejta trashëgimore është degë e së drejtës dhe disiplinë shkencore.

1. Si degë e së drejtës - E drejta trashëgimore përfshinë dispozitat ligjore me të cilat rregullohen të gjitha marrëdhëniet në raste të trashëgimit.

2. Si disiplinë shkencore - E drejta trashëgimore përfshinë tërësinë e studimeve me të cilat studiohen normat juridike dhe raportet në rastet e trashëgimit.

II. QËLLIMI I STUDIMIT TË LËNDËS:

Kjo lëndë mësimore ka për qëllim t'i mësoj studentët me njohurit themelore mbi rregullimin juridik të marrëdhënieve familjare, marrëdhënieve martesore dhe marrëdhënieve tjera që lindin nga to si dhe marrëdhëniet trashëgimore. Studentët do të fitojnë njohuri për këtë lëmi të së drejtës duke u bazuar në të drejtën pozitive në Kosovë me vështrim krahasimor edhe me të drejtat tjera pozitive.

Studentët me marrjen e njohurive nga kjo lëndë, do të kenë mundësi që me qasje logjike dhe analitike t'i zgjedhin detyrat të cilat kërkohen në fushën e së drejtës familjare dhe trashëgimore. Te studentët do të zhvillohen shkathtësi për qasje kritike për ligjin dhe argumentimin ligjor në fushën e së drejtës familjare dhe trashëgimore.

III. METODA E LIGJËRIMIT DHE MËSIMIT (STUDIMIT):

Gjatë semestrit çdo javë do të ligjerohet materia e paraparë sipas planprogramit mësimor. Në ligjerata që do të mbahen në mënyrë interaktive do të përfshihen edhe studentët. Studentët mund të punojnë punime seminarike nga materia e përfshirë me planprogram. Punimi seminarik do të prezentohet gjatë ligjeratave me gojë, dhe pastaj do të hapet debati ku do të përfshihen të gjithë studentët. Punimi seminarik i prezantuar me sukses vlerësohet dhe llogaritet gjatë formimit të notës përfundimtare.

Shqyrtimi i rasteve, gjatë mësimdhënies do të jetë pjesë e të mësuarit, përmes të cilave studentët do të kenë mundësi studimin në mënyrë analitike, të problemeve nga fusha e së drejtës familjare dhe trashëgimore, duke përfshirë edhe studimin e vendimeve gjyqësore. Shqyrtimi dhe zgjidhja e rasteve do të bazohet në të drejtën pozitive në Kosovë, duke mos i përjashtuar edhe krahasimet me të drejtat tjera pozitive.

Ushtrimet, janë pjesë e mësimit nga e drejta familjare, përmes të cilave studentët do të mësojnë më shumë rreth zbatimit praktik të së drejtës familjare dhe trashëgimore.

IV. VLERËSIMI DHE NOTIMI:

Gjatë vlerësimit të dijes, përkatësisht formësimit të notës përfundimtare vlerësohen komponentat:

1. rregullsia dhe aktiviteti në ligjerata, vlerësohet prej 0-10 pikë;
2. prezantimi i punimit seminarik, vlerësohet prej 0-10 pikë;
3. kollokuimi vlerësohet prej 0-30 pikë;
4. provimi përfundimtar vlerësohet prej 0-50 pikë.

Në fund mbledhen të gjitha pikat dhe formësohet nota sipas tabelës:

Numri i pikëve	Nota
95 – 100	10
87 - 94	9
77 – 86	8
67 – 76	7
60 – 66	6
deri 59	5

TEMAT E LIGJERATAVE QË DO TË LIGJEROHEN GJATË SEMESTRIT

I. E DREJTA FAMILJARE

Java e Parë:

Temat:

Studentët do të njoftohen me përmbajtjen e lëndës në përgjithësi, mënyrën e zhvillimit të mësimit gjatë semestrit dhe literaturën.

- nocioni dhe emërtimi i të drejtës familjare, objekti i të drejtës familjare
- metodat e studimit të së drejtës familjare, parimet themelore të së drejtës familjare
- burimet e së drejtës familjare
- marrëdhëniet e së drejtës familjare me disiplinat tjera shkencore

Literatura: **Hamdi Podvorica, E drejta Familjare, fq. 5-28**

Java e Dytë:

Temat:

- nocioni i familjes
- llojet e familjes
- funksionet e familjes
- struktura e lidhjeve familjare (gjinia e gjakut, gjinia e krushqisë, gjinia e adoptimit)

Literatura: **Hamdi Podvorica, E drejta Familjare, fq. 29-56**

Java e Tretë:

Temat:

- hyrje në të drejtën martesore dhe kuptimi i saj
- objekti i të drejtës martesore
- subjektet e të drejtës martesore
- parimet themelore të të drejtës martesore
- fejesa
- martesa dhe kuptimi i saj
- qëllimet martesore
- kushtet për lidhjen e martesës
- pengesat martesore
- ndalesat martesore
- kushtet formale për lidhjen e martesës
- procedura paraprake
- lidhja e martesës

Literatura: **Hamdi Podvorica, E drejta Familjare, fq. 59-100**

Java e Katërt:

Temat:

- të drejtat dhe detyrat personale të bashkëshortëve
- zgjidhja e martesës, mënyrat, shkaqet dhe procedura e shkurorëzimit
- pasojat juridike të zgjidhjes së martesës
- bashkësia jashtëmartesore si dukuri shoqërore
- efektet juridike të bashkësisë jashtëmartesore

Literatura: **Hamdi Podvorica, E drejta Familjare, fq. 101-144**

Java e Pestë:

Temat:

- Marrëdhëniet mes prindërve dhe fëmijëve
- subjektet e të drejtës prindërore
- legjitimimi i fëmijëve, statusi i fëmijëve martesor, statusi i fëmijëve jashtëmartesor
- kundërshtimi i amësisë dhe kundërshtimi i atësisë
- procedurat e kundërshtimi të amësisë dhe atësisë
- njohja e amësisë dhe e atësisë
- vërtetimi i amësisë dhe atësisë me vendim të gjykatës
- e drejta prindërore (kuptimi dhe objekti)
- marrëdhëniet personale dhe pasurore mes prindërve dhe fëmijëve
- ushtrimi i të drejtës prindërore
- pezullimi, kufizimi, heqja dhe vazhdimi dhe mbarimi i të drejtës prindërore

Literatura: **Hamdi Podvorica, E drejta Familjare, fq. 147-201**

Java e Gjashtë:

Temat:

- adoptimi / birësimi
- procedurat e themelimit të adoptimit, efektet juridike të adoptimit
- vendosja e organizuar e fëmijës në familjen tjetër për përkujdesje
- detyrimet e ushqimit (mbajtja financiar)
- personat e detyruar për dhënien e ushqimit
- kushtet për dhënien e ushqimi

Literatura: **Hamdi Podvorica, E drejta Familjare, fq. 203-242**

Java e Shtatë:

Temat:

- marrëdhëniet pasurore
- regjimi i kontraktimit
- e drejta e kujdestarisë
- personat nënë kujdestari
- kujdestaria ndaj fëmijëve të mitur
- kujdestaria ndaj personave me pazotësi të veprimit (zotësi të hequr të veprimit)
- rastet e veçanta të kujdestarisë
- rastet e veçanta të kujdestarisë kur nuk janë përcaktuar me dispozita ligjore
- pushimi i kujdestarisë

Literatura: Hamdi Podvorica, E drejta Familjare, fq. 243-283

Java e Tetë:

PROVIMI I NDËRMJETËM (KOLLOKVIUMI I PARË)

II. E DREJTA TRASHËGIMORE

Java e Nëntë:

Temat:

- nocioni dhe emërtimi i të drejtës trashëgimore
- objekti i të drejtës trashëgimore
- parimet themelore të së drejtës trashëgimore
- burimet e të drejtës trashëgimore dhe metodat

Literatura: Hamdi Podvorica, E drejta Trashëgimore, fq. 9-37

Java e Dhjetë:

Temat:

- trashëgimi me ligj
- koha dhe vend i çeljes (hapjes) së trashëgimit, trashëgimlënësi, trashëgimtari,
- aftësia për të trashëguar
- bazat e thirrjes në trashëgim
- sistemet për caktimin e radhëve për thirrje në trashëgimi ligjore
- radhët e trashëgimisë, e drejta e përfaqësimit dhe e drejta e shtimit

Literatura: Hamdi Podvorica, E drejta Trashëgimore, fq. 39-62

Java e Njëmbëdhjetë:

Temat:

- trashëgimia e domosdoshme, padenjësia për trashëgim,
- pranimi i trashëgimit
- renoncimi (heqja dorë) nga trashëgimi
- ndarja e trashëgimisë
- transaksionet ndërmjet të gjallëve (inter vivos)

Literatura: Hamdi Podvorica, E drejta Trashëgimore, fq. 63-95

Java e Dymbëdhjetë:

Temat:

- trashëgimia testamentare
- forma, kuptimi dhe përmbajtja e testamentit
- zotësia për të bërë testament
- pavlefshmëria e testamentit
- legu
- llojet e testamentit

Literatura: Hamdi Podvorica, E drejta Trashëgimore, fq. 99-147

Java e Trembëdhjetë:

Temat:

- procedura e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore
- kuptimi dhe parimet e procedurës së shqyrtimit të trashëgimisë
- kompetenca e gjykatës në procedurën e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore
- përgatitja e seancës trashëgimore
- seanca trashëgimore
- aktvendimi për trashëgimi
- mjetet e rregullta të goditjes së vendimit
- mjetet e jashtëzakonshme të goditjes së vendimit

Literatura: Hamdi Podvorica, E drejta Trashëgimore, fq. 151-181

Java e Katërbëdhjetë:

PROVIMI I NDËRMJETËM (KOLLOKVIUMI I DYTË)

Java e Pesëmbëdhjetë:

PROVIMI PËRFUNDIMATARË

LITERATURA

I. LITERATURA THEMELORE NGA E DREJTA FAMILJARE

- **Hamdi Podvorica, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2011**

LITERATURA E REKOMANDUAR NGA E DREJTA FAMILJARE

1. Libra

- **Abdulla Aliu & Haxhi Gashi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2007**
- **Aleks Laurasi, Marrëdhëniet familjare, Laurasi, Tiranë, 2001**
- **Valentina Zaçe, Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar, Tiranë, 1999**
- **Santhipi Begeja, E drejta familjare e Shqipërisë, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë**
- **Leslie J.Harris & Lee E, Teitelbaum, Family Law, Aspen Law & Business, New York, 2000**
- **D.Kelly Weisberg & Susan Frelich Appleton, Modern Family Law- cases and materials, Law, Aspen Law & Business, New York, 1998.**
- **M.Alinčić- A.Abramović- D. Hrabar – J-Lozić – A, Korać, Obiteljsko Pravo, Narodne Novine, Zagreb, 2001.**

2. Akte normative

- **Ligji i Familjes i Kosovës, i hyrë në fuqi me datën .16.02.2006**
- **Ligji mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare, GZ e KSAK nr,10/84, date 28 mars 1984**
- **Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë nr. 90/62 datë 08.05.2003**
- **Deklarata e përgjithshme e OKB-së për të drejtat e njeriut, 1948,**
- **Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, 1950**
- **Konventa OKB-së, për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, 1979**
- **Konventa e OKB-së, për të drejtat e fëmijëve, 1990**

II. LITERATURA THEMELORE NGA E DREJTA TRASHËGIMORE

- **Hamdi Podvorica, E Drejta Trashëgimore, Prishtinë, 2010**

LITERATURA E REKOMANDUAR NGA E DREJTA TRASHËGIMORE

1. Libra

- Dr. Juliana Latifi, E drejta e trashëgimisë në Kosovë, Prishtinë 2010
- Nazmi Bicoku, E drejta e trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë, Onrufi, 1999
- Andria Gams, Hyrje në të drejtën civile, Pjesa për të drejtën e trashëgimit, Prishtinë 1986
- Francesko Galgano, E drejta private, Luarasi, 2003

2. Akte normative

- Ligji për Trashëgimi i Kosovës, i hyrë në fuqi me dt. 4 shkurt 2005
- Kodi i Republikës së Shqipërisë, Pegi, 1996
- Deklarata e përgjithshme e OKB-së për të drejtat e njeriut, 1948,
- Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, 1950
- Konventa OKB-së, për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, 1979
- Konventa e OKB-së, për të drejtat e fëmijëve, 1990